

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Maj, 2022*

Greva njëorëshe e 12 majit

I tërë sistemi arsimor në këtë veprim paralajmërues sindikal



Kryesia Ekzekutive e BSPK-së duke dëgjuar me kujdes vlerësimet që janë bërë për situatën aktuale dhe duke u bazuar në zërin e anëtarësisë ka vendosur të shkohet në grevën njëorëshe. Këtë vendim e kanë përkrahur njëzëri edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve dhe më 12 maj, edhe një herë u dëshmuua uniteti dhe besimi i ... (faqe 4)

U vlerësua madhështore protesta e 20 majit organizuar nga BSPK-ja

Pjesëmarrje masive dhe qëndrim i dinjitetshëm i anëtarëve të SBASHK-ut



Në takimin e jashtëzakonshëm të ... (faqe 4)

Letër nga SBASHK
deputeteve dhe deputetëve të
Parlamentit të Kosovës

**Angazhohuni që të ketë
dialog e marrëveshje të
Qeverisë me sindikatat**

SBASHK-u vazhdon
angazhimet që të ... (faqe 7)

Flet kryetari i Kuvendit të
Sindikatës së Arsimit
Parauniversitar për
Prishtinën, Ahmet Pllana

**Ndjem krenar për
përkushtimin dhe arritjet e
SBASHK-ut**



Ahmet Pllana me vite e
dekada ... (faqe 3)

SBASHK vazhdon me angazhimet në shërbim të
anëtarësisë

**Trajnime në Suharekë, Prishtinë, Drenas e në
Prizren**



Krahas shumë aktiviteteve ... (faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Krenaria për njerëzit e dinjitetshëm



Është ndjenjë e mirë krenaria për ngjarjet e caktuara e besa edhe për sjelljet plot dinjitet për njerëzit që i njeh e angazhohesh çdo ditë me ta. Një ndjenjë e tillë e krenarisë ishte edhe më 20 maj 2022. Mijëra punëtorë të arsimit e dëshmuar unitetin e SBASHK-ut dhe krahas kësaj treguan se punëtorët e arsimit edhe në pikën e vapës e duke marshuar nga komunat e deri në kryeqytet janë të kulturuar dhe dinë ta ruajnë, edhe kur janë të pakënaqur me qasjen e institucioneve, figurën e punëtorit të arsimit. Filluan ata të bëheshin bashkë që në

orën 13 dhe fotografoheshin që ta mbajnë në kujtesë këtë ditë. Marshuan me hapa të rëndë, por as edhe një fjalë e rëndë a fyese ndaj institucioneve a individëve. Kjo pjesëmarrje dhe ky qëndrim i dinjitetshëm la përshtypje te qytetarët, mediet dhe te policia e Kosovës. Protesta me mijëra pjesëmarrës e dërgoi mesazhin drejt Qeverisë me kërkesa të qarta, por edhe me plot dinjitet.

Ky qëndrim i dinjitetshëm u tregua edhe në grevën njëorëshe të 12 majit. Unitet i shkëlqyer dhe vendosmëri në kërkesat legjitime e të argumentuara. Është e natyrshme që unë ndjem krenar për njerëzit e dinjitetshëm e që janë kolege e kolegë të mi nga e tërë Kosova e që nga çerdhet e deri në Universitete.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Flet kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën, Ahmet Pllana

Ndjem krenar për përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut



Ahmet Pllana me vite e dekada i është përkushtuar misionit në edukimin dhe arsimimin e brezave. Ishte edhe udhëheqës shkollë për disa vite. Të gjithë ata që e

njohin, e respektojnë shumë sepse reflekton respekt për njerëzit dhe ka qetësi e qëndrim të dinjitetshëm në situatat plot sfida. Për gazetën tonë Ahmeti shpalos kujtimet nga aktivitetet arsimore e nga aktivitetet e shumta sindikale.

Arsimimi sot :

Keni qenë udhëheqës shkollë e tani edhe udhëheqës sindikal, cila ishte më e vështirë ?

Ahmeti:

Vet misioni i punëtorëve të arsimit është i veçantë. Është nder për njeriun që ka bërë rrugëtim të gjatë në këtë profesion duke realizuar misionin e shenjtë në edukimin e brezave. Fati i popullit tonë nëpër shekuj e edhe në vite e dekada ishte plot dhembje e sfida. Atdheu kërkoi nga ne që ta mbrojmë arsimin dhe gjuhën tonë përball furtunave të pushtuesit dhe gjenerata jonë e kreu këtë detyrë të shenjtë. Edhe pas lufte u gjendem përball sfidave dhe bashkërisht i kaluam me sukses. Kur punohet me tërë qenien e bashkë me koleget e kolegët në të njëjtin mision, atëherë vështirësitë tejkalohen. Jam ndjerë krenar me kolegët e mi në kohën sa isha udhëheqës në shkollë, ndjem krenar edhe tani si kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën.

Arsimimi sot :

Çka do të veçonit në aktivitetet dhe angazhimet e SBASHK-ut ?

Ahmeti:

SBASHK-u është sindikatë me përvojë të madhe e të ndritur. U formua atëherë kur duhej bërë angazhime e mobilizim në ruajtjen e shkëndijave të dijes nga furtunat e pushuesit. Tërë ato vite qëndruam në ballë të angazhimeve dhe arritëm ta kryejmë misionin tonë të shenjtë. SBASHK-u vazhdoi me aktivitetin në shërbim të arsimit e të anëtarësisë edhe në gjithë këto vite të pasluftës dhe është shembulli më i mirë i sindikalizmit të vërtetë dhe i unitetit. Sindikatat tjera na marrin shembull për të mirë dhe kjo na bën krenar.

Arsimimi sot :

Kjo do të thotë se SBASHK-u ka shënuar arritje të shumta në shërbim të anëtarësisë

Ahmeti:

Po. Nëse kthehemi edhe në vitet e shkuara shohim se SBASHK ishte vazhdimisht në angazhime e aktivitete në shërbim të anëtarësisë duke shënuar rezultate e arritje të vazhdueshme. SBASHK-u ishte dhe mbetet zë i fuqishëm i anëtarësisë sepse udhëheqësit e zgjedhur me votën e lirë të anëtarësisë e krijuan me punë e përkushtim besimin, të cilin arritën ta ruajnë edhe përkundër shumë sfidave të kohës. Ky unitet i krijuar dhe besimi i ndërsjellë të obligon që të angazhohesh pa u ndalur. Uniteti i krijuar dëshmohej në çdo kohë e në çdo situatë. Në SBASHK vendimet i marrim bashkërisht dhe bashkërisht angazhohemi për jetësimin e tyre.

Kështu do të vazhdojmë sot e gjithmonë duke qenë shembull për të mirë dhe duke u angazhuar në shërbim të anëtarësisë.

Gjatë muajit


Greva njëorëshe e 12 majit

I tërë sistemi arsimor në këtë veprim paralajmërues sindikal

Kryesia Ekzekutive e BSPK-së duke dëgjuar me kujdes vlerësimet që janë bërë për situatën aktuale dhe duke u bazuar në zërin e anëtarësisë ka vendosur të shkohet në grevën njëorëshe. Këtë vendim e kanë përkrahur njëzëri edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve dhe më 12 maj, edhe një herë u dëshmuar uniteti dhe besimi i ndërsjellë mes anëtarësisë.



Pas mbajtjes së grevës njëorëshe edhe në ndërrimin e dytë Këshillat Greviste kanë raportuar për rrjedhën e këtij veprimi sindikal duke konfirmuar se në nivel vendi greva ishte e realizuar pothuajse 100%, përjashtim bën vetëm shkolla fillore "Iliria" në Prishtinë, të cilët nuk e kanë respektuar thirrjen për grevë, për shkak se në këtë shoqatë sindikale ende nuk janë kryer zgjedhjet e ndoshta janë keq informuar nga ish kryetari i kësaj shoqate sindikale.



Pjesëmarrja kaq e madhe në grevën paralajmëruese obligon udhëheqësit e SBASHK-ut që të vazhdojnë të jenë shumë këmbëngulës drejt realizimit të kërkesave tanimë të njohura dhe presim refleksim pozitiv nga Qeveria për t'i realizuar kërkesat. SBASHK në komunikim me anëtarësinë u është drejtuar me apel që të bëhen gjitha përgatitjet e duhura për veprimet tjera sindikale nëse Qeveria nuk reflekton pas këtij veprimi sindikal.



U vlerësua madhështore protesta e 20 majit organizuar nga BSPK-ja

Pjesëmarrje masive dhe qëndrim i dinjitetshëm i anëtarëve të SBASHK-ut

Në takimin e jashtëzakonshëm të SBASHK-ut me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve, por edhe në takimin e Kryesisë ekzekutive të BSPK-së është analizuar rrjedha e

protestës së 20 majit dhe ishte vlerësim i përbashkët se ky veprim sindikal ka shënuar pjesëmarrje të madhe të sindikalistëve e veçmas të anëtarësisë së SBASHK-ut dhe se ata meritojnë respekt të lartë për qëndrimin e

dinjitetshëm gjatë marshimit dhe gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur protesta.



Këtë madhështi dhe masivitet protestës ia kanë dhënë veçmas anëtarët e SBASHK-ut, të cilët kishin nisur rrugëtimin me kohë nga gjithë komunat dhe nga Universitetet. Po ashtu kishin kërkuar edhe kolegët e kolegët tanë nga çerdhet që të marrin pjesë që të gjithë në këtë veprim sindikal, por për hir të prindërve që punojnë e do të kishin telashe se çfarë të bëjnë atë ditë me fëmijët e tyre të vegjël, ne u këshilluam me përfaqësues të çerdheve dhe arritëm marrëveshje që këto institucione të punojnë, ndërsa në protestë të jenë përfaqësues të autorizuar nga çerdhet. SBASHK shpreh respekt edhe për mirëkuptimin e nxënësve, studentëve dhe të prindërve që dëgjuan apelin që të premten shkollat e Universitetet të mos punojnë ngase të punësuarit në këto institucione arsimore ishin pjesë e protestës.

Gëzon fakti se edhe opinioni dhe mediet e kanë vlerësuar lart këtë protestë duke veçuar qëndrimin e dinjitetshëm të pjesëmarrësve dhe kulturën e lart të tyre ngase ata në as edhe një moment nuk kishin brohoritje me fjalë fyese ndaj dikujt, por zëshëm e me

brohoritje tregonin respektin për SBASHK-un dhe kujtonin kërkesat legjitime.



Pas kësaj në takimin e jashtëzakonshëm të SBASHK-ut me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve dhe në takimin e Kryesisë ekzekutive të BSPK-së duke debatuar për hapëtat e radhës u vendos unanimisht që të respektohet detyrimi dhe obligimi nga Ligji mbi grevat që para se të shkohet në grevën e përgjithshme të aktivizohet ndërmjetësuesi ligjor për të ndërmjetësuar në nisjen e dialogut mes BSPK-së dhe Qeverisë e me qëllim të arritjes së marrëveshjes së pranueshme për kërkesat e anëtarësisë, marrëveshje kjo që është pastaj obligative.



Në kuadër të ndihmesës që çështjet të zgjidhen me dialog, kryetari Rrahman Jasharaj bashkë me përfaqësues të tjerë të SBASHK-ut janë takuar me zv/ministrin Dukagjin Pupovci dhe anëtarë të kabinetit të Ministres Nagavci për të bashkëbiseduar për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit dhe gjetjes së mundësive për zgjidhje të kërkesave legjitime të punëtorëve të arsimit pa pasur nevojë për veprime të tjera sindikale. Të dy palët janë pajtuar që ta mbajnë të informuar njëra-tjetrën për çdo angazhime situatë të krijuar.

Po ashtu përfaqësuesit e SBASHK-ut në kuadër të delegacionit të BSPK-së janë takuar me 6 deputetë të VV-së, të cilët janë shprehur se po flasin në emër të gjithë deputetëve të këtij subjekti politik. Përfaqësuesit sindikalë kanë ripërsëritur gjithë shqetësimet dhe kërkesat e anëtarësisë duke u shprehur se deri tani ka munguar gatishmëria e institucioneve për dialog dhe se kjo ka sjellë deri të veprimet sindikale që janë organizuar deri tani. Deputetët kanë dëgjuar me kujdes gjithë diskutimet e përfaqësuesve sindikalë e pastaj janë deklaruar se do të angazhohen që të vazhdojnë takimet e dialogu me deputetët, Komisionet Parlamentare, por edhe me Qeverinë me qëllim që bashkërisht të gjenden zgjidhje të pranueshme të kërkesave legjitime të anëtarësisë e brenda mundësive reale të buxhetit.



SBASHK-ut uron që dialogu i nisur të vazhdojë edhe përmes ndërmjetësuesit të licencuar dhe të arrihen marrëveshje të pranueshme. SBASHK-u edhe një herë shpreh respekt të lartë për qëndrimin e dinjitetshëm të pjesëmarrësve në protestën e 20 majit, qëndrim ky që na bën të palëkundur në mbrojtjen e interesit dhe kërkesave të anëtarësisë që nga çerdhet e deri në Universitete dhe sektorin e kulturës.



SBASHK vazhdon me angazhimet në shërbim të anëtarësisë **Trajnime në Suharekë, Prishtinë, Drenas e në Prizren**

Krahas shumë aktiviteteve e angazhimeve, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror e në koordinim të plotë me kryetarët e nivelit komunal sindikal vazhdojnë ta respektojnë vullnetin e anëtarësisë për organizimin e trajnimeve të licencuara. Ky aktivitet është zhvilluar në Suharekë, Prishtinë, Drenas e Prizren.

Kështu të shtunën e 21 majit kanë nisur trajnimet “Aplikimi i programeve kompjuterike” mbahet në Duhel, në ambientet e shkollës “Sadri Duhla” me trajneren Bahrije Elshani, pastaj trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me trajnerin prof. dr. Hysen Sogojeva, aktivitet ky që zhvillohet në shkollën “Shkëndija” në Suharekë dhe trajnimi “Edukimi Medial dhe roli i tij në zhvillimin demokratik” me trajneren Arbenita Hoxha, që po ashtu mbahet në shkollën “Shkëndija”. Kryetari i Kuvendit të Arsimit Parauniversitar për Suharekën, Nazim Gashi, ka vizituar pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve duke i përshëndetur në emër të kryesisë qendore e duke i përgëzuar për vullnetin që

edhe në ditë vikendi të marrin pjesë në trajnime për të aritur njohuri të reja që do t'i vënë në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Ai ka shprehur respekt për stafin qendror të SBASHK-ut dhe ka falënderuar edhe trajneret për angazhimin e përkushtimin duke shprehur bindjen se ata do të arrijnë të bartin njohuri të reja te pjesëmarrësit gjatë gjithë ditëve të trajnimit.



Po ashtu ky aktivitet është zhvilluar edhe në shkollën “Rasim Kiçina” të Drenasit me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në

mësimdhënie”, udhëhequr nga trajneri Nexhmedin Gruda. I njëjti trajnim, ka vazhduar, i udhëhequr nga trajneri Albert Samadraxha në shkollën “Avdyl Frashëri” të Prizrenit.



Edhe në shkollën “Dardania” të Prishtinës është organizuar trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me trajneren Valentina Sopjani.



Pjesëmarrësit i ka vizituar kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën, Ahmet Pllana, i cili ka përgëzuar pjesëmarrësit dhe ka shprehur respekt meritore për SBASHK-un, që krahas shumë angazhimeve të tjera, tregon përkushtim të vazhdueshëm për të respektuar vullnetin e anëtarësisë duke organizuar trajnime.

Letër nga SBASHK deputeteve dhe deputetëve të Parlamentit të Kosovës

Angazhohuni që të ketë dialog e marrëveshje të Qeverisë me sindikatat

SBASHK-u vazhdon angazhimet që të gjendet mundësi për dialog e marrëveshje me Qeverinë për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë e për të mos pasur nevojë për greva e protestë të përgjithshme. Në kudër të këtij angazhimi SBASHK-u u ka dërguar apel në adresat e tyre zyrtare elektronike deputeteve e deputetëve të Parlamentit të Kosovës duke apeluar te ta që të angazhohen për debat konstruktiv dhe që të ketë dialog e marrëveshje të Qeverisë me sindikatat. Në këtë apel thuhet:

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë të parlamentit të Republikës së Kosovës, SBASHK-u dhe sindikatat tjera duke respektuar zërin e anëtarësisë së tyre me muaj të tërë janë angazhuar edhe përmes BSPK-së, që të kenë dialog me Qeverinë e për të arritur marrëveshje të pranuar për kërkesat legjitime të të punësuarve në arsim dhe në sektorët tjerë.

Mungesa e gatishmërisë së Qeverisë për dialog ka bërë që të krijohet situatë e tensionuar dhe SBASHK e sindikatat tjera kanë nisur me veprime të kufizuara e të përshkallëzuara sindikale, por duke i dhënë kohë e

SBASHK-u kërkon angazhimin e Kuvendit për marrëveshjen e Qeverisë me sindikatat



SBASHK letër deputetëve për ndihmë në dialog me Qeverinë

hapësirë Qeverisë për dialog e marrëveshje.

Ju kujtojmë se ndodhi protesta e 8 prillit me pjesëmarrjen vetëm të udhëheqësve sindikal, por Qeveria heshti, ndodhi edhe greva njëorëshe më 12 maj në tërë sektorin e arsimit që nga çerdhet e deri në universitete dhe prapë Qeveria heshti. Të premtën, më 20 maj, do të jetë protestë me pjesëmarrje të të punësuarve në arsim dhe tërë sektorin publik dhe nëse edhe pas kësaj Qeveria hesht dhe nuk angazhohet për dialog e marrëveshje me sindikatat, atëherë arsimi dhe sektorët tjerë po shkojnë drejt grevës së përgjithshme, të cilën ne nuk e dëshirojmë dhe prandaj po ju drejtohem juve të nderuara deputete dhe juve deputetë të nderuar që të angazhoheni dhe në një debat konstruktiv të ndihmoni që të ketë dialog e marrëveshje të Qeverisë me sindikatat.



SBASHK: Deputetë angazhohuni që të ketë dialog e marrëveshje të Qeverisë me sindikatat

Maj 18, 2022

f t in

Takimet me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve Unitet në vendime, unitet në angazhime të përbashkëta

Me qëllim të konsultimeve e bashkëbisedave lidhur me situatën aktuale SBASHK vazhdon të mbajë takime me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve . Në këto takime bashkëbisedohet, jepen ide dhe pastaj edhe merren vendime për angazhimet dhe veprimet në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë. Këto takime dëshmojnë unitetin në vendime dhe unitet në angazhime të përbashkëta. Kështu ishte edhe në dy takimet e radhës në të cilat pjesëmarrësit kanë marrë informacione për gjendjen momentale dhe për angazhimet pas protestës madhështore të 20 majit. Ishte vlerësim i përbashkët se protesta ishte edhe një dëshmi e unitetit në SBASHK dhe dëshmoi edhe qëndrimin e dinjitetshëm të pjesëmarrësve, që ishin shembull i shkëlqyer i sjelljes së njerëzve të arsimuar. Pjesëmarrësit kanë debatuar edhe për hapat e ardhshëm dhe janë pajtuar që BSPK-ja të angazhojë ndërmjetësuesin ligjor për të tentuar të

nis dialogun e mirëfilltë mes Qeverisë dhe sindikatave. Ishte konstatim i përgjithshëm se ky veprim është obligativ sipas Ligjit për grevat dhe se edhe duhet respektuar, si hap i fundit, para grevës së përgjithshme.



Në këto takime u diskutua edhe për detyrat konkrete dhe u tha se edhe në të ardhmen do të vazhdohet me komunikimin dhe me angazhimet e përbashkëta në shërbim të anëtarësisë. U analizuan edhe përgatitjet e bëra dhe u kujtuan edhe detyrat konkrete që na presin në kudër të angazhimit për realizimin traditës së dërgimit të një numri të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve të SBASHK-ut për pushime në bregdetin shqiptar.

SBASHK vazhdon të informojë ETUCE-n për situatën aktuale në arsim Angazhim i vazhdueshëm në mbështetje të SBASHK-ut

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) në vazhdimësi ka shprehur interesim për gjendjen në arsimin e Kosovës dhe për gjithë sfidat e angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe në përpjekjet për realizimin kërkesave legjitime. Drejtorja e përgjithshme Suzan Flocken bashkë me stafin e ETUCE-s vazhdimisht kanë dhënë këshilla e mbështetje për gjithë angazhimet dhe ka dërguar edhe letra në adresë të Qeverisë duke dëshmuar përkrahjen që SBASHK-u gëzon nga ky union që numëron 11 milionë anëtarë.

SBASHK ka informuar lidhur me gjendjen aktuale në arsim dhe për gjithë veprimet sindikale që janë organizuar me pjesëmarrjen e anëtarësisë së sindikatës sonë në kuadër të BSPK-së.

“Jam i nderuar t’ju shpreh falënderimet e gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut si dhe falënderimet e mija, si përfaqësues i tyre, për angazhimet tuaja që keni bërë për ta dërguar shqetësimin dhe zërin tonë përmes shkresave dhe takimeve që keni pasur në kuadër të BE-së me zyrtarë të lartë atje dhe nga letra Juaj kuptuam se na keni bërë një përkrahje e ndihmesë të madhe se besojmë se Qeveria e Kosovës do të ndryshoj qasjen ndaj sindikatave dhe do të nis me dialogun e mirëfilltë dhe me angazhimin për gjetjen e zgjidhjes së pranueshme për kërkesat tona”, thuhet në

letren e kryetarit të SBASHK, dërguar drejtores së përgjithshme të ETUCE, znj. Suzan Flocken për të vazhduar me informacionet për aktivitetet aktuale.



Sindikata e Bashkuar e
Arsimit, Shkencës dhe
Kulturës e Kosovës

The Union of Education,
Science and Culture of
Kosovo

Kryetar/President
Rahman JASHARAJ
rahman.jasharaj@sbashk-rks.org

Nënkryetar/Vice-President
Vjollca SHALA
vjolca.shala@sbashk-rks.org

Sekretare e Përgjithshme/
Secretary General
Jehona ORUÇI
jehona.oruci@sbashk-rks.org

Përgjegjësi administrativ/
Administrative responsible
Ymer YMERI
ymer.ymeri@sbashk-rks.org

Adresa/Address:
Rr. Agim Ramadani pr.
Qendra e Studenteve -
Drejtorja
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
sbashk2004@yahoo.com
info@sbashk-rks.org
Tel +383(0) 38 226 940
www.sbashk-rks.org

SBASHK / UESCK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
The Union of Education, Science and Culture of Kosovo

Prishtinë, 27.05.2022

To:
[European Trade Union Committee for Education](mailto:European.Trade.Union.Committee.for.Education@ec.europa.eu)
Ms.Suzan Flocken, European Director

INFORMATION LETTER

Dear Mrs. Suzan,
First of all, I feel obliged to apologize for the late response, but I believe in your understanding because we had many engagements and meetings with union activists due to the current situation and because a lot of preparation had to be done for union action.

I am honored to express my gratitude to you from all the members of SBASHK, as well as my gratitude, as their representative, for the commitments you have made to send our concern and voice to the staff of the European Commission, respectively to the staff of the Directorate for the Labor Commission. From your letter, we understand that you have given us great support and assistance. We believe that the Government of Kosovo will change its approach to trade unions and start with genuine dialogue and commitment to finding an acceptable solution for our requirements.

Dear Mrs. Suzan, let me briefly inform you about the activities, events, and union actions that we have undertaken from the previous announcement (May 11th) until today.

Seeing that the Government is hesitating and running away from the dialogue, we organized a one-hour warning strike in the entire education system, from kindergartens to universities. The strike was magnificent, with the participation of almost 100% of employees in the whole education system. Part of the strike were even those few workers who have not yet joined us. The one-hour strike was also attended by members of other unions that are part of the BSPK, such as civil servants, customs, energy, and others. Despite this, the Government did not reflect and did not even have a meeting with representatives of SBASHK and other unions. Therefore, as warned, mass protests were organized and held on May 20th as a final warning before the general strike.

SBASHK, two days before the protest, had two consecutive meetings with the Minister of Education, Mrs. Nagavci, and her cabinet, but without an outcome. Instead, there was even a tendency in her vocabulary to create fear with punitive measures against our membership. However, this did not even have an effect. After all, the members of SBASHK proved their determination and faith in their union on May 20th with massive participation and a dignified attitude in the protest, which was highly praised by the public and the media because there were neither offensive calls nor an incident.



“E nderuara znj. Suzan duke parë se Qeveria po heziton dhe po i ik dialogut, organizuam grevë njëorëshe paralajmëruese në tërë sistemin arsimor, që nga çerdhet e deri edhe në Universitete dhe greva ishte madhështore e me pjesëmarrjen në të, të po thuaj 100% e të punësuarve në tërë sistemin arsimor. Madje pjesë e grevës ishin edhe ata pak punëtorë që ende nuk janë anëtarësuar te ne. Në grevën njëorëshe morën pjesë edhe anëtarë të sindikatave tjera, që janë pjesë e BSPK-së, si shërbyesit civilë, dogana, energjetika e të tjerë. Edhe përkundër kësaj Qeveria nuk reflektoi dhe nuk pati as edhe një takim me përfaqësues të SBASHK-ut e të sindikatave tjera dhe prandaj, ashtu si ishte paralajmëruar, u organizua dhe u mbajt protesta masive më 20 maj, si paralajmërim i fundit para grevës së përgjithshme.

SBASHK dy ditë para protestës pati dy takime radhazi me Ministren e Arsimit, znj. Nagavci dhe kabinetin e saj, por pa as edhe një rezultat e në vend të kësaj madje kishte tendenca në fjalorin e saj që të krijohet frikë me masa ndëshkuese ndaj anëtarësisë sonë, por kjo nuk pati as edhe një efekt sepse anëtarësia e SBASHK-ut vendosmërinë dhe besimin në sindikatën e vet e dëshmoi me 20 maj me pjesëmarrje masive e me qëndrim të dinjitetshëm në protestë, e cila nga opinioni e mediet u vlerësua lart sepse nuk pati as thirrje ofenduese a as edhe një incident. Pas kësaj proteste SBASHK bashkë me federatat tjera e duke respektuar Ligjin për grevat kemi angazhuar ndërmjetësuesin ligjor, që të tentojë të ndikojë te

Qeveria për nisjen e dialogut dhe gjetjen e zgjidhjeve konkrete për kërkesat tona legjitime. Kjo është kërkesë obligative, që duhet shfrytëzuar, para se të shkohet në grevë të përgjithshme. Nëse edhe angazhimit të ndërmjetësuesit ligjor nuk sjellin deri të dialogu aq i kërkuar nga ne, atëherë SBASHK-u do të shkojë në grevë të përgjithshme në tërë sistemin arsimor, që nga çerdhet e deri në Universitete dhe kjo do të ndodh me të kaluar të afatit ligjor për ndërmjetësimin. E nderuara znj. Suzan, Ministria e arsimit duke dashur të bëj presion në anëtarësinë tonë dhe a dobësojë unitetin kishte përgatitur vendimin që pasi më 20 maj institucionet arsimore nuk punuan sepse punëtorët arsimor ishin në grevë, të zëvendësohej kjo ditë në të shtunën e 28 majit, ne u takuam me zv/ministrin Pupovci e kabinetin e ministres dhe u shprehëm kategorikisht kundër kësaj duke u thënë që të angazhohen për dialog e zgjidhje të kërkesave sepse në të kundërtën do të ketë edhe ditë të tjera të humbura të mësimi për arsye të grevës së përgjithshme, që mund të ndodh. Ministria pas kësaj e tërhoq këtë vendim.

E nderuara znj. Suzan jemi të lirë që Juve t’ju informojmë se kemi pasur shumë kujdes në veprimet sindikale pikërisht për hir të nxënësve sepse po i afrohem gradualisht edhe përfundimit të këtij viti mësimor dhe nuk kishim dëshirë që ata të pësojnë për arsye të mungesës së përgjegjësisë së Qeverisë”, ka informuar SBASHK drejtoreshën e përgjithshme të ETUCE-s, znj. Suzan Flocken.

